



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
MINISTRI

Nr. 5108/ Prot.
2

Tiranë, më 27/09/2022

URDHËR

Nr. 500 datë 27/09 2022

“PËR AUTORIZIMIN E ORGANIZATËS JOFITIMPRURËSE “FORUMI I GRUAS ELBASAN” NË OFRIMIN E SHËRBIMEVE TË NDIHMËS JURIDIKE PARËSORE TË GARANTUAR NGA SHTETI”

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, e ndryshuar, të nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar, të neneve 13, shkronja “b” dhe 15 të ligjit nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, të Vendimit nr.55, datë 06.02.2019 të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave dhe dokumentacionit për autorizimin e organizatave jofitimprurëse që ofrojnë ndihmë juridike parësore të garantuar nga shteti”;

URDHËROJ:

1. Autorizimin e organizatës jofitimprurëse “Forumi i Gruas Elbasan”, e regjistruar si organizatë jofitimprurëse me Vendimin nr. 4030, datë 07.01.2000, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, identifikuar me NIPT K52609201K, me adresë Rr. “11 Nëntori” p.70, Elbasan, për ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”.
2. Ky autorizim është i vlefshëm për një periudhë 2 (dy) vjeçare nga hyrja në fuqi e këtij urdhri.
3. Ngarkohet Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.
4. Ngarkohet Sektori i Arkiv-Protokollit për njoftimin e këtij urdhri.
5. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I DREJTËSISË

Ulsi Manja

